## IV Stilistika e shprehësisë

### Fonostilistika

***Burimet fonetike***. I gjithë spektri i vetive të tingujve të gjuhës dhe ndërthurjet e tyre, denduria e shpërndarja fshehin mundësi për vlera shprehëse. Tingujt ndikojnë mbi ne, madje marrin vlera emotive dhe estetike. Kjo anë e shqipes së sotme është studiuar pak, megjithatë gjuha e gjallë, folklori e letërsia na zbulojnë një pasuri përftesash. Me një ndarje të parë do të dallojmë:

1. Përftesat që mbështeten te variacioni tingullor.
2. Përftesat që mbështeten te organizimet tingullore.
3. Përftesat që mbështeten te lidhja e tingujve me kuptimet.

***Variacioni fonetik*** vjen nga dallimet që ndeshen ndërmjet dialekteve, shtresave shoqërore e kulturore, në ligjërimin bisedor e të shkujdesur, me trajtat e vjetruara, brenda vetë normës letrare, madje deri te vetë shmangiet individuale, si dhe për shkak të kërkesave emocionale shprehëse.

*Shqiptimi* merr pjesë në dallimin e ligjërimeve.***Shqiptimi letrar*** i nënshtrohet një norme dhe ka natyrë librore, duke ndjekur shkrimin.Variantet kundrejt tij sjellin me vete ngjyrime krahinore, sociale, kulturore, që shfrytëzohen në *teatër, film, gojtari dhe humor*.P.sh. sot tifozët me ngulm e shkruajnë *Tirona*, duke nxjerrë variantin dialektor si më emocional. Fjala vjehërr po evoluon në dy drejtime. Drejt zbutjes së rr-së vjehra dhe forcimit të rr-së vjehrra, varësisht prej raporteve dhe nga kush shqiptohet,nga dhëndurët a nga nuset.
Te "Çipi i palaçove" (1922) Faik Konica luan me tri trajta të emrit të *kontinentit Avropa, Evropa, Evropi*.

*Theksi* përgjithësisht në gjuhën shqipe është i ngulitur.Për normën paraqesin problem disa dallime. P.sh. orientalizmat *kafe, perde, xhezve, penxhere* etj. Gegërishtja ka tërhequr theksin në paraoksitone dhe e njëjta në shqipe del me dy theksime: *teneqe* dhe *teneqe, agë* dhe *aga*. F. Noli i shkruan dy trajtat e emrit flamur:

*O Flamur gjak, o Flamur shkabë* (theksi mbi *a*)
*Flamur i kuq, Flamur i zi* (theksi mbi *u*)

Po edhe në gojtari e në publicistikë ndeshet: *Lart flamujt*! (theksi mbi *u*)
*Gati jam, por s'jam gati*. (varg popullor)

Një ndarje në rrokje e fjalëve del në thirrje kolektive, gjatë shqiptimit të parullave, në ndeshjet sportive, ose për humor. *Ti-ra-na*! Disa arsimtarë nuk e shqiptojnë rrokjen e fundit p.sh.*është poli-, ë? Polivalente pra*. Poezia për nevoja të ritmit e të rimës, pranon cungimin dhe shtimin e zanoreve, si p.sh. *Tinë s'më ke nënë,/ mor, por më ke grua*. (popullore)

Tempi është shpejtësia e shqiptimit brenda njësisë së kohës. Ai ndërron me ndjenjat, me synimet e folësit.Edhe të folurit me zë të ulët ndikon në ngjyrimet e rrjedhës së ligjërimit, p.sh.si shfaqje të intimitetit.

***Organizimet fonetike.***Përgjithësisht organizimet fonetike çojnë te një orkestrim tingullor i thënieve, që kthehet në *paronomazi*, domethënë në tingëllim të afërt të gjymtyrëve të ndryshme. *Paronomazia* është pothuaj po aq e pranishme sa edhe ritmi në poezi, po jo vetëm në poezi. **Gjergj Fishta** ka bërë një lojë humoristike te "*Gomari i Babatosit*":

Se Shqypnia fushë e male
Asht ba sot aksidentale

Desha t'them oksidentale.
Rima në poezi është e njohur që në shkollë.Sot ndeshen në poezi rimat e brendshme, jehonat tingullore dhe *aliteracionet*, duke u bërë kompleks orkestrimi tingullor.P.sh.

Pranë Ajkunës mjeron gjaku

Anës gjakut qan Ajkuna. (Xh. Spahiu)

Ritmi është, pa dyshim, themeli i organizimit të poezisë, por ai ka rëndësi edhe për shqiptimin në rastet e tjera dhe për prozën.
Në fjalimet, në kumtimet zyrtare, në lajmet ritmi është më i përmbajtur.

Për t'u perceptuar organizimi ritmik bëhen ndërtime sintaksore të rregullta, simetrike e paralele.Segmentimi i rrjedhës ligjërimore me ritëm ndikon edhe në anën semantike, duke vendosur lidhje kuptimore plotësuese.Ritmi mund të jetë edhe ngjitës edhe rënës. Po sjellim një copë nga "*Dimri i madh*":
*"Treni po kthehej bosh nga Durrësi.Ishte treni i parë që po kthehej bosh nga Durrësi.Një tren që kthehet bosh nga Durrësi, mendoi makinisti nën ritmin e zhurmës së rrotave.Një tren që kthehet bosh.Një tren që kthehet.Një tren që kthehet bosh.Një tren që kthehet.Një tren bosh.Një tren i vdekur.Tren bosh.Tren i vdekur.Tren bosh. Tren I vdekur."* (*Dimri i madh*, I. Kadare)
Kështu po mendon makinisti nën atë ritëm për të imituar ritmin e trokullimës së rrotave të trenit: *tak-tak, tak-tak-tak.*

Këto burime shprehëse i kanë shfrytëzuar gjithnjë gjuha e gjallë, folklori.Lojërat e fjalëve dhe humori. P.sh. kështu formohen ***fjalëshpejtat***: *Plepi plak i plasur pak palcë paska pasur*; ***fjalët e urta***: Kush s'ka kokë ka këmbë. Ku ka zë s'është pa gjë.Shprehjet që shoqërojnë lojrat e fëmijëve.

Vjershërimi, ashtu siç e studion metrika, është një paraqitje e formave të ndryshme të organizimit, të mbështetura në ritmin.

***Simbolizmi tingullor.*** Shoqërimet tingull kuptim quhen *simbolizëm tingullor*, kur vendosen qëllimisht për të arritur efekte të ndryshme.

Tingujt e veçuar nuk bartin kuptim. Megjithatë për arsye të ndryshme vendosen lidhje ndërmjet tingullit e kuptimit dhe atëherë kjo është një burim shprehësie. Edhe në sitemin e gjuhës ka disa modele që marrin vlerë për kategori të ngushta fjalësh, p.sh. dhëmboret në gjuhën shqipe përdoren për të dhënë trokitjet: *tak, trak, dëng*, ndërsa buzoret për goditjet dhe shpërthimet, *bam, bum, buf, bëlldum*. Ndjenja gjuhësore kërkon kudo një kuptim dhe kështu tingulli c jep përshtypjen e zvogëlimit për shqiptarët: *i vockël, picker, njëckë*. Tingujt ndikojnë për të krijuar një atmosferë rreth kuptimit, anasjelltas, edhe kuptimi ndikon për mënyrën e përceptimit të tingujve.

***Grafematika.***Trajta shkrimore përbën grafemikën, që e studion grafematika.Për stilistikën kanë rëndësi po njësoj variantet shkrimore dhe organizimet e tyre për shprehësi.Edhe shkrimi ruan gjurmë të historisë së përdorimit gjuhësor, që përbëjnë vlera.

Dallohen dy nivele të grafemikës. I pari ka të bëjë me shkronjat.Dallohen shkronja të mëdha e të vogla; të drejta, të zeza, cursive e të nënvizuara.

Niveli i dytë ka të bëjë me formësimin e përgjithshëm, që u nënshtrohet teknikave, duke u nisur nga formati i letrës, duke vazhduar me vendosjen e lëndës, gjerësinë e kolonave, hapësirat, titujt, kornizat e shoqërimin me lëndën ilustruese.

**Morfostlistika**

Shqipja është gjuhë flektive dhe fjalët e saj të eptueshme kanë trajta të ndryshme. Trajta të caktuara brenda një kategorie leksikogramatikore shfrytëzohen për qëllime shprehësie.

**Emri**. Emrat kanë dy trajtat, të shquarën dhe të pashquarën. Ky dallim stilistikisht lidhet me një mënyrë vështrimi. Trajta e pashquar, në shumë raste krijon përshtypje të dejtëpërdrejtë, pikturon tablonë që shënon emri. Kështu nisin nganjëherë pjesët në prozë: Natë. Dimër. Qetësi., dhe vihen si tituj poezish e pikturash. Poezia "Natë" e Dritëro Agollit, prandaj vijon menjëherë: *Flenë bashkëfshatarët e mi të lodhur*.

Huazim stilistik është për shqipen përdorimi i *një* para emrave të përveçëm. Atë e kanë furor autorë që nga fan Noli e deri te Dh. Shuteriqi, po ndeshet edhe në artikujt sportive:

Trajtat e shumësit të disa emrave në shqipen përdoren me ngjyrime stilistike, p.sh.: qen-të – qenër, çakall-aj – çakenj, qerrata-qerratenj – qerratallarë. Shumë emra mund të ndërtojnë shumësin me prapashtesën -ra: ide-ra, poezi-ra, teori-ra etj.

Te emrat abstraktë një shumës i tillë sjell shumëfishim të imazhit, që shoqërohet me njëfarë mjegullimi me ngjyrim negative: frikë-ra.

Emrat që shënojnë masë të vetme, shumësi quhet augmentativ: rrodhën *qiejt*; humbi në *dhera* të huaja.

Një emër abstrakt mund të përdoret si konkret, një jofrymor si frymor, një emër veprimi si emër rezultati të veprimit dhe anasjelltas.

*Midis nesh u bë një heshtje e shkurtër dhe plot pritje.*

*Ajo ishte akoma në periferinë e vetmisë së saj.*(Ura me tri harqe)

*Pjesa anësore e një tmerri* (Gjakftohtësia)

*Sa shumë vetmi bën sot* – titulli i një poezie të Blerina Gjokës.

Emrat e përveçëm prej kohësh u janë nështruar përftesave shprehëse në letërsinë tonë. A.Z. Çajupi e ka kthyer në stilemë Adhamudhin. Emrat nuk përdoren në kuptimi e tyre të parë. F. Konica e ka quajtur heroin e vet Dr. Gjilpëra, Salemboza është përngjitje salep e bozë për të paraqitur prapambeturinë anadollake.

Gjuha shqipe po pret Kristoforidhët e rinj (S.Luarasi, Fjala shqipe, 1954.).Ku kam rrit ata platonat, demostenët e ciceronat (Gj. Fishta, Mrizi i zanave). Sa herë detit janë derdhur nizamët,/kanë mbirë bregut Mujot, Selamët. (A. Vinca, Legjenda). Ata që ju shkojnë nga pas Esat Toptanëve të sotëm. ((Shekulli, 17.9.1998)

Gjinia e emrave është përcaktuese për mënyrën e personifikimit. Te Çajupi kemi zonja dhelpër. Atij i është dashur një emër në mashkullore: Zu një dhelpër vjedhurak. Si figurë quhet enalagë, e cila përmbledh edhe përdorimin e një pjese të ligjëratës atje ku duhej tjetra, si: Qetësia është vdekje. *Shëtitja ishte kënaqësi.Për Qetësia është vdekjeprurëse.Shëtitja ishte e kënaqshme.*

Gjinia dhe trajtat dialektore.Ka disa lujatje të gjinisë për shkak të prejardhjes dialektore ose të ndryshimeve historike.Emrat me –izëm, pas viteve 90-ta, janë përdorur edhe me trajtat femërore, për raste si nacionalizma, që dalin me ngjyrim të caktuar.D.Agolli ka përdorur pleshtetsha (Pleshti). Femërorizime stilistike janë: derre (sepse ekziston dose), shpirte, xhane.

Rasat dhe përdorimi i tyre.Ka ende trajta të vjetëruara të disa rasave, të cilat mbajnë lidhje sinonime ndërmjet tyre. Trajtat e rrjedhores malesh-it; zemre-t, kallëzues: në malt. A. Xhuvani ishte për ta ruajtur kallëzoren e pashquar si: në gjuhë të sotme në vend të në gjuhën e sotme. Rrjedhorja pa parafjalë pëlqehet sot nga poetët: fushave të atdheut në vend të nëpër fushat e atdheut.

**Mbiemrat.**Dallojmë mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm.Mbiemrat e nyjshëm vinë zakonisht nga një pjesore e nyjëzuar. Formimi i mbiemrave të panyjshëm me prapashtesa si –or, -ak. P.sh. letërsia botërore dhe jo e përbotshme. Te përkthimi i Nolit gjejmë. Historiani arab e mençurak tregon këtë histori rëndësore, lartësore, hollësore…(Don Kishoti). Gjejmë "zemërimi i shenjtë sulltanor." (Ura me tri harqe).

Cilësimi është edhe nxjerrja në dukje e diçkaje të brendshme për sendin, dukurinë a qenien.Zgjedhja e mbiemrit është si treguese e një vlerësimi, edhe e një qëndrimi, prapa të cilit është një mënyrë vështrimi a konceptimi të botës. Arrijmë deri te dallimi në mes të mbiemrit dhe epitetit. Mbiemri është ajo që thotë gramatika. Epiteti është njëmbiemër plus vlerësimi, vështrimi dhe veprimi i ligjëruesit, ose epiteti=mbiemër+subjekti i ligjëruesit. Mbiemri që thotë diçka të re bëhet më i pavarur, merr peshë dhe I afrohet rolit të kallëzuesit.

Termi fjalë në gjuhësi merr disa mbiemra si togje terminoligjike (fjalë të parme, fjalë shërbyese, njërrokshe) dhe disa janë epitete (fjalë të rënda, të mëdha, të ashpra, të ngrohta, të ëmbla etj.) dhe fjalë të gjalla, të zgjuara, të marra.

Te "Histori e Skënderbeut" të Naimit gjejmë: fjalëbukur, punëmirë, mëmëshumë, mendjeshumë, brengëgjatë etj.

Stilemat mbiemërore shtrihen ndërmjet dy skajeve: cilësorët stereotipë të poezisë gojore dhe epitetet e papritura ose që bashkojnë fusha të përvojës sonë. Këtë e ka nisu F.Konica: gjersia elegante e derës; forma e shkathët e penxhereve.; qytetet e plagosura të Gjermanisë; pyll i hutuar. Te Ismail Kadare gjejmë: shkëlqim atomik; flokët e akullt; shekuj detarë (Shekulli XX).

Fillimi i një fjalie me një mbiemër prejpjesor karakterizon gjuhën librore: "I brumosun që në moshë të re me një dashuri të zjarrtë për memedheun…" (Sh. Demiraj, A. Xhuvani – dijetar i shquar, 1990).

Togfjalëshi emër emër dhe emër mbiemër.Në gjuhën e folur kemi *shtëpi fshati* (emri në rolin e atributit (breg lumi, dritë dielli). Rrjedhorja është në marrëdhënie sinonime me gjinoren: doreza dyersh dhe doreza të dyerve. Jo çdo gjinore mund të zëvendësohet me mbiemër: Këmba e tryezës, prerja e pyllit, trimëria e heroit. Por kemi mjegullat e demerit dhe mjegullat dimërore, kaltërsia e qiellit dhe kaltërsia qiellore.

Kalimi i fjalës në një pjesë tjetër të ligjëratës e çliron shprehjen nga disa lidhje dhe u hap shteg lidhjeve të tjera.

**Foljet.**Folja është pjesa e ligjëratës më e pasura me trajta gramatikore, rrjedhimisht edhe me hijezime kuptimore hijezime kuptimore të tyre.Folja është bërthama e fjalisë, është pjesa ndërtimore e ligjërimit.

Në gjuhën letrare janë tashmë të kodifikuara trajtat, porn ë përdorimin e përditshëm ruhet një larmi e madhe, shpesh me dallime shprehëse që nuk janë studiuar.

Që te N. Frashëri gjejmë me vlerësimin stilistik trajta dialektore:

E me ardh' ke ti o Shkodrë, të shof Drinin e Bujanën,
Krujën e Skënderbeut, q'i ka pas' dhan' ner Shqypnisë,
Tue bam' me trimni luftë e m'e mund mren' e Turqisë.
(Bagëti e bujqësia)

Paskajorja e gegërishtes edhe sot është çështje e diskutueshme. Janë pranuar si variante edhe trajtat ish dhe kish krahas ishte dhe kishte.

Përdorimi i një trajte foljore të një kohe të caktuar në vend të një kohe tjetër është dukuri e zakonshme. Këtë e përmend edhe gramatika, ndonëse kjo është fushë e stilistikës! Përdorimi i së tashmes (historike) në vend të kohëve të shkuara është dukuri e shpeshtë dhe ajo gjallëron rrëfimin:

Diçka i bjen në mend; çel derën ngadalë dhe hyn Brenda. Në shtypin e kohëve të fundit, shpërdorimi i kësaj pëeftese ka sjellë praninë e ndajfoljeve që shënojnë kohë të shkuar pranë foljeve në të tashmen: Dje komisioni jep vendimin për kandidatët… PD nis fushatën dje në Tiranë. E tashmja në fjalët e urta (e tashme etike): Kush punon fiton! E tashmja në vend të së ardhmes: nesër jam këtu etj.

E pakryera në vend të së kryerës së thjeshtë: Këtë ditë, pikërisht kur HUniadi kapërcente grykat e Ballkanit, u pagëzua edhe Hamza Kastrioti. F. Noli, Historia e Skënderbeut). Më 1895 vdiste Kristoforidhi… në vend të kapërceu dhe vdiq. Përftesa lejon që të përshkruhen të nërthurura disa ngjarje, duke theksuar njëkohësinë e tyre, sepse folja me cak e përjashton njëkohësinë.

**Pjesët e tjera të ligjëratës**

**Përemrat**.Prania e plotë e përemrave vetorë dhe pronorë në tekst është tipar libror.Përemrat janë të nevojshëm për mënjanimin e përsëritjes së emrave.

Një trajtë e shkurtër, e quajtur dhanore etike, sjell një ngarkesë të ndjeshme si në gjuhën e folur edhe në letërsi: na e vranë, na e shanë,/ na i thanë tradhëtor. (F. Noli) Na ngordhi kali, i ranë thonjtë. (Sh. Musaraj)

Përdorimi i përemrave në shumës në shenjë të mirësjelljes ka filluar të bjerë. Hasim edhe në përdorimin e përemrave dëftorë me ngjyrim miratues ose përçmues para emrave (atë fytyrë, ata trimat etj.).

**Numërorët**. Numërorët shpesh dalin me rol intensifikues dhe me të shpjegohen hiperbolat e bisedës.

Të kam thënë një milion here; Të hëngëshun shtatëqin dreqër; Qe nandë vjet nandë varra në shtat m'i ka!

Në veprat shkencore parapëlqehen numërorët e shkruar me shifra, në veprat letrare jepen me fjalë.

**Ndajfoljet**.Ndajfolja del si gjymtyrë mjaft e lëvizshme në fjalinë shqipe. Në eposin e kreshnikëve e gjejmë mjaft shpesh në krye: Fort po shndrit njaj diell e pak po nxe! Fort Halili kenka idhnue.

Formime gati të panevojshme të ndajfoljeve: shkurt-shkurtimisht, drejt-drejtësisht, afër-afërsisht, egër-egërsisht etj.

Grupi tjetër i ndajfoljeve i ndërtuar në vend të togut emër me parafjalë, si: me hollësi-hollësisht, me qetësi-qetësisht etj.

Ndajfolja me –isht është më abstrakte dhe prandaj për një larmi të shprehjes e vlen që të shihet gjerësia e zgjedhjes, si: gjllërisht-gjithë gjallëri, me gjallëri, në mënyrë të gjallë; hollësisht – me hollësi, në mënyrë të hollësishme, fije e për pe; anglisht – në gjuhën angleze etj

Ndajfoljet me –shëm i gjejmë që te Buzuku (i përmishëriershim) dhe janë zakonshme në dialektin verior: përgjumshëm, pijshëm, dhe janë përhapur në letërsi: lirshëm, natyrshëm, gëzueshëm etj

**Parafjalët**. Janë të shpeshta përdorimet me anën, në drejtim, në saje, për arsye, për shkak, me përjashtim, në lidhje me, në krahasim me, në pajtim me etj. Ha me lugë dhe marr me anë të një luge; pres me thike dhe pres me anë të një thike etj.

**Lidhëzat**. Janë të njoura lokucionet: *në mënyrë që, nga shkaku që, me qëllim që, për arsye se, për shkak se, duke qenë se, me kusht që* etj.

Janë të shpeshta edhe fjalitë pa lidhëza (asindetike) dhe bashkërenditëse.

*Dhe prapë pellgje gjaku, dhe vera, dhe dimri, dhe kohërat e përzieranjëra me tjetrën, dhe ishte mbi atë fushë, edhe shi edhe diell, edhe bore me blerim, e lule, e shkreti dimri njëherësh. (I. Kadare)*

**Pjesëza**.Përdorimi I pjesëzave, p.sh.po është themelore dhe kur përdoret në rastet si: po de, merr ngjyrimin; *S'dihet kur vjen.-Pale kur vjen; Thuaje! Thuaje de*!

Orietalizmin bile gjuha e shkrimit kër kon zëvendësimin me madje etj.

**Pasthirrma**.Janë karakteristike për gjuhën e folur dhe kanë të bëjnë me ngjyrimin subjektiv.Pranohen drejt vetën në kontekst.Trajta e disa pasthirrmave nuk është e ngulitur përfundimisht p.sh.përsëritja pa-pa-pa-pa etj.